

FUNKSIONET DHE DETYRAT E QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE

Qendra e Shërbimeve Arsimore (këtu e në vijim QSHA) është institucion publik i krijuar me ligj, në varësi të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, që ka për mision ofrimin e shërbimeve dhe sigurimin e aksesit publik në fushën e arsimit të lartë dhe arsimit parauniversitar”.

QSHA-ja është institucion i posaçëm për organizimin, monitorimin, mbikëqyrjen e problemeve të reformës arsimore, për sigurimin e cilësisë në fushën e vlerësimit të arritjeve dhe të provimeve. Ajo ushtron funksion teknik, profesional, mbështetës dhe rekomandues të politikave të vlerësimit dhe të organizimit të provimeve të maturës e të shtetit, matrikullimit, njohjes së diplomave të arsimit të mesëm dhe të lartë të nxënësve dhe studentëve që kanë mbaruar jashtë vendit, regjistrimit të formave të diplomave, pajisjes së IAL-ve me regjistra etj.

QSHA-ja ka për objekt veprimtarie ofrimin e shërbimeve për nxënësit, studentët, kandidatët për të marrë titullin e një profesioni të rregulluar, shkollat, IAL-të, urdhrat profesionalë, institucionet dhe të tretët.

Shërbimet ndaj të tretëve ofrohen nga QSHA-ja pas miratimit nga ministria përgjegjëse për arsimin. QSHA-ja i ofron këto shërbime kundrejt tarifave të pagesave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave nr.560, datë 29.09.2018, “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Qendra e Shërbimeve Arsimore”.

Veprimtaria e QSHA-së orientohet drejt organizimit, monitorimit, mbikëqyrjes së problemeve të reformës arsimore, për sigurimin e cilësisë në fushën e vlerësimit të arritjeve dhe të provimeve.

Misioni i QSHA-së konsiston:

- a. Në edukimin e vlerave demokratike e kombëtare dhe në zotërimin e njohurive dhe shprehive për ekonominë moderne të tregut.
- b. Në edukimin cilësor sipas nevojave dhe interesave të individit, komunitetit dhe shoqërisë në përgjithësi dhe sipas standardeve evropiane.
- c. Në barazinë e shanseve për edukim për të gjithë qytetarët e Republikës së Shqipërisë.
- d. Në mekanizma të përgjegjshmërisë së shërbimit arsimor ndaj personave që përfitojnë drejtpërdrejtë dhe shoqërisë civile në tërësi.
- e. Në ofrimin e shërbimeve arsimore me cilësi dhe profesionalizëm.
- f. QSHA-ja konsideron themelore për suksesin e misionit të saj:
- g. Orientimin e të gjitha veprimtarive vlerësuese drejt formimit të nxënësve e mbështetjes së mësuesve.
- h. Ngritjen e vazhdueshme profesionale të punonjësve të saj.
- i. Mbështetjen në një informacion të bollshëm dhe të besueshëm në hartimin e planeve dhe në realizimin e veprimtarive vlerësuese.
- j. Mbështetjen në kërkimin shkencor, si një mjet efektiv për përmirësimin e vlerësimit në arsim.
- k. Transparencën e proceseve, procedurave dhe vendimmarrjeve.

- l. Bashkëveprimin, bashkëpunimin dhe komunikimin e vazhdueshëm vertikal, horizontal, të brendshëm dhe të jashtëm.
- m. Debatin rreth alternativave brenda institucionit dhe ndërmjet institucioneve në varësi të Ministrisë përgjegjëse për arsimin.
- n. Përgjegjësinë individuale dhe fleksibilitetin në gjetjen e rrugëve për të përmbushur objektivat.
- o. Etikën qytetare dhe profesionale.
- p. QSHA-ja, në përmbushje të misionit të saj:
- q. Ofron këshilla për Ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe institucionet e larta shtetërore për të gjitha çështjet e lidhura me vlerësimin në arsimin parauniversitar.
- r. HKryen pilotime për rishikimin e vlerësimit në përputhje me përparësitë e politikave arsimore në vend.
- s. Kryen studime dhe boton dokumente të vlerësimeve kombëtare e rajonale, në marrëveshje me Ministrinë përgjegjëse për arsimin.
- t. Mbështet shkolla dhe institucione të tjera arsimore me materiale të ndryshme orientuese në zbatim të procesit të vlerësimit.
- u. Monitoron, në partneritet me agjenci të ndryshme, cilësinë e arritjeve të nxënësve në lloje, nivele e cikle të ndryshme shkollimi.
- v. Bashkëpunon me organizma dhe institucione të tjera që punojnë në fushën e arsimit, si me institucionet e varësisë së Ministrisë përgjegjëse për arsimin, me institucionet e arsimit të lartë dhe me institucione dhe agjenci të huaja që veprojnë në fushën e vlerësimit të arsimit.
- w. Merr pjesë në projekte të ndryshme me institucione dhe organizata brenda dhe jashtë vendit.
- x. Kryen studime të ndryshme që lidhen me procesin e zhvillimit të provimeve të shtetit dhe jep rekomandime për përmirësimin e cilësisë në sistemin arsimor.

FUNKSIONET E QSHA JANË:

QSHA-ja funksionon sipas strukturës së miratuar me urdhër të Kryeministrit.

QSHA-ja përbëhet nga:

- a) Drejtoria e Vlerësimit;
- b) Drejtoria e Shërbimeve Arsimore;
- c) Drejtoria e Provimeve të Shtetit;
- d) Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

QSHA-ja funksionon sipas organikës së mëposhtme:

1. Drejtori i QSHA-së dhe sekretari/ja e tij.
2. Drejtoria e Vlerësimit përbëhet nga drejtori i kësaj drejtorie dhe dy sektorë:
 - a) Sektori i Provimeve dhe Vlerësimeve Kombëtare/Ndërkombëtare, i përbërë nga një përgjegjës sektori dhe shtatë punonjës;

- b) Sektori i Administrimit të Provimeve, i përbërë nga një përgjegjës sektori dhe katër punonjës.
3. Drejtoria e Shërbimeve Arsimore përbëhet nga drejtori i kësaj drejtorie dhe katër sektorë:
- a) Sektori i Regjistrimit të Studentëve, i përbërë nga përgjegjësi i sektorit dhe tre punonjës.
 - b) Sektori i Regjistrimit të Nxënësve në Arsimin Parauniversitar, i përbërë nga përgjegjësi i sektorit dhe tre punonjës.
 - c) Sektori i Njohjes së Diplomave të Arsimit Parauniversitar dhe Legalizimeve, i përbërë nga përgjegjësi i sektorit dhe tre punonjës.
 - d) Sektori i Njohjes së Diplomave të Arsimit të Lartë, Pajisjes së IAL me Regjistra dhe i Regjistrimit të Formave të Diplomave, i përbërë nga përgjegjësi i sektorit dhe tre punonjës.
4. Drejtoria e Provimeve të Shtetit përbëhet nga drejtori i kësaj drejtorie dhe dy sektorë:
- a) Sektori i Administrimit të Provimeve të Shtetit, i përbërë nga një përgjegjës sektori dhe dy punonjës.
 - b) Sektori i Menaxhimit të Fondit të Pyetjeve, i përbërë nga një përgjegjës sektori dhe dy punonjës.
5. Sektori i Shërbimeve Mbështetëse:
- a) Përgjegjës Sektori;
 - b) Specialist finance;
 - c) Specialist Jurist;
 - d) Specialist Arkiv/Protokoll.

Drejtori i Përgjithshëm i QSHA-së emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Marrëdhëniet e punës së punonjësve të QSHA-së rregullohen në bazë të Kodit të Punës.

Funksionet e QSHA-së

QSHA kryen këto funksione kryesore:

- a) Zhvillon provimet kombëtare, kryen procesin e vlerësimit të arritjes së nxënësve dhe administron bazën e të dhënave të këtyre rezultateve.
- b) Kryen dhe administron vlerësime të jashtme kombëtare dhe ndërkombëtare dhe/ose me kampionim për arritjet e nxënësve të sistemit arsimor parauniversitar.
- c) Ofron kontribut në hartimin e politikave arsimore e të strategjive dhe në zbatimin e tyre.
- d) Përpunon dhe analizon rezultatet e provimeve kombëtare, të vlerësimeve, të provimeve të shtetit, sipas standardeve bashkëkohore, dhe raportet vjetore të cilat i publikon.

- e) Organizon dhe administron Provimin e Shtetit, që zhvillohet përmes teknologjisë digjitale, duke bashkëpunuar me autoritetet kompetente përkatëse, sipas ligjit për profesionet e rregulluara.
- f) Krijon bazën shtetërore të të dhënave për kandidatët e regjistruar në Provimin e Shtetit.
- g) Digjitalizon fondet e pyetjeve të miratuara nga komisionet e Provimit të Shtetit dhe e zhvillon këtë provim, përmes teknologjisë digjitale.
- h) Trajnon periodikisht personelin organizues dhe mbikëqyrës të Provimit të Shtetit dhe të provimeve kombëtare.
- i) Publikon on-line programin orientues të këtij provimi dhe fondet e pyetjeve për çdo profesion të rregulluar.
- j) Administron bazën e të dhënave për arsimin parauniversitar.
- k) Krijon, arkivon, përditëson dhe administron bazën elektronike të të dhënave për arritjet e nxënësve në provimet kombëtare.
- l) Koordinon procesin e aplikimit në institucionet e arsimit të lartë, për ndjekjen e studimeve në programet e ciklit të parë, atyre të integruara dhe programet profesionale.
- m) Pranon aplikimet, koordinon procesin e shqyrtimit dhe vendimmarrjes nga Komisioni i Posaçëm i ngritur në QSHA, si dhe nëpërmjet nëpunësve të caktuar shërben si sekretariat teknik i Komisionit për procedurat e njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të ardhur nga jashtë vendit (sistemi parauniversitar). QSHA-ja administron dokumentacionin e këtij procesi sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.
- n) Administron databazën e njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të sistemit parauniversitar.
- o) Legalizimin e dëftesave, diplomave dhe dokumenteve të arsimit parauniversitar.
- p) Pranon aplikimet, koordinon procesin e shqyrtimit dhe vendimmarrjes nga Komisioni i Posaçëm i ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, si dhe nëpërmjet nëpunësve të caktuar shërben si sekretariat teknik i Komisionit për njohjen e diplomave, certifikatave e gradave të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit dhe njohja e titujve të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë. QSHA-ja administron dokumentacionin e këtij procesi sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.
- q) Administron databazën e diplomave të njehsuara për arsimin e lartë, të lëshuara nga një institucion i huaj i arsimit të lartë dhe diplomave të nxënësve të ardhur nga jashtë vendit.
- r) Përcjell rezultatet e provimeve të shtetit në ministritë e linjës, urdhrat profesionalë dhe institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar.
- s) Krijon dhe administron regjistrin kombëtar të studentëve të të gjitha cikleve dhe një bazë të dhënash për institucionet e arsimit të lartë, lidhur me programet e studimit, diplomat apo certifikatat që ato lëshojnë.
- t) Pajis çdo student, në regjistrimin fillestar në një institucion të arsimit të lartë, me një numër unik matrikullimi që e shoqëron deri në marrjen e diplomës ose certifikatës për ciklin përkatës të studimit, sipas përcaktimeve të bëra me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

- u) Realizon studime që lidhen me provimet kombëtare, provimet e shtetit dhe të dhënat e arsimit të lartë.
- v) Merr masa për sigurinë e bazave të të dhënave që administrojnë.
- w) Ofron çdo shërbim tjetër të lidhur me objektin e veprimtarisë së saj, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe shërbime të tjera të miratuara nga ministri përgjegjës për arsimin.
- x) Kryen regjistrimin e formave të diplomave dhe pajisjen e IAL-ve me regjistra.
- y) Kontribuon në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore, të cilat janë pjesë e objektit të veprimtarisë së saj.

-